

Shoqëria qytetare dhe Kuvendi – ndërtimi i partneriteteve që bëjnë dallim

THIRRJE DREJTUAR ORGANIZATAVE QYTETARE

Në vitin 2009 Instituti nacional demokratik për marrëdhënie ndërkombëtare (NDI) – Maqedoni filloi programin për mbështetje të iniciativave legjislative të organizatave qytetare në Republikën e Maqedonisë.

Pas implementimit të suksesshëm disavjeçar të këtij programi, Instituti me mjetet e USAID-it dëshiron ta zgjerojë atë përmes përfshirjes së gjeneratës së re të organizatave qytetare. Në këtë drejtim inkurajojmë aplikime nga të gjitha sferat, ndonëse prioritet gjatë përzgjedhjes do të kenë iniciativat, që kanë të bëjnë me **integrimin e Maqedonisë në BE**, përfshirë edhe sferat e **zhvillimit demokratik, të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, mundësitë e barabarta dhe inkluzionin, politikave sociale, arsimin, të rinjtë dhe mjedisin jetësor**.

Njëri ndër qëllimet themelore të këtij projekti është fuqizimi i kapaciteteve ekzistuese të organizatave qytetare në sferat e përfaqësimit ligjor dhe lobimit, monitorimit të politikave publike, si dhe ndihmës në ndërtimin e koalicioneve ndërmjet sektorit joqeveritar dhe deputetëve.

Ky program do:

- t'i mbështesë organizatat në përmirësimin e shkathtësive dhe njohurive të tyre ligjore, me qëllim që të rritet kontributi qytetar në procesin legjislativ dhe mbikëqyrja më qenësore në implementimin e politikave publike;
- ta avancojë bashkëpunimin tematik ndërmjet organizatave qytetare dhe deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, komisionet dhe grupet parlamentare; dhe
- t'iu ndihmojë organizatave qytetare në ndërtimin e koalicioneve edhe në komunikim efikas me publikun në lidhje me iniciativat, qëllimet dhe angazhimet e tyre.

Programi do të fillojë me realizim në shtator të vitit 2016 dhe do të zgjasë dy vite. NDI do t'ë sigurojë mbështetje profesionale, materiale dhe teknike për organizatat e përzgjedhura.

Organizatave qytetare të interesuara për pjesëmarrje në këtë program duhet të dërgojnë **letër motivuese** (letër me synim) **më së voni deri të premtën, më 19 gusht 2016**, ku do ta përshkruajnë organizatën e tyre dhe aktivitetet e realizuara, si dhe do të ofrojnë një përshkrim të shkurtër të projekt-propozimit për iniciativë ligjore, që duan ta realizojnë. Përveç kësaj aplikimi duhet të përmbajë edhe portofol të shkurtër për punën e tyre (lista e projekteve të realizuara paraprakisht) me shpjegim të ndërlidhjes ndërmjet aktiviteteve të deritanishme dhe iniciativës së propozuar.

Aplikimet duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në: ndimacedonia@ndi.org – aplikimet përmes postës nuk do të merren parasysh.

Për informacione plotësuese paraqituni në zyrën e NDI-së në numrin 02/3131-177, ose shkruani Filipit në fchaparowski@ndi.org ose Sllagjanës në spanovska@ndi.org. Organizatat e përzgjedhura në rrethin e parë do të ftohen në intervistë.